



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 26, datë 13.10.2025

PËR

KORIGJIMIN E GABIMIT NË VENDIMIN NR.13 DATË 30.07.2024
DHE LEJES ME NR. SERIAL 000208 “PËR PËRDORIM BURIMI UJOR
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK” HEC
“SHYTAJ” SUBJEKTIT “ERIM” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 141, të ligjit Nr.29/2024 “Për burimet ujore”, vendimit nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi uhor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 dhe 2 të nenit 112, të Kodit të Proedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ”. 1-Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ. 2-Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njëhësuar të tij. AMBU dhe Zyra e Administrimit te Basenit Lumor Drin Bunë pasi konstatoi se pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e gabimit material, Këshilli i Basenit Lumor Drin Bunë.

V E N D O S I:

1. Korigjimin e gabimit në Vendimin nr.13 datë 30.07.2024 dhe Lejes me nr. serial 000208 “Për përdorim burimi uhor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik” nëpërmjet HEC “SHYTAJ”, me vendndodhje: në përroin e Hetmit dhe Përroi Sheshit të Vogël, Njësia Administrative Fushë Bulqizë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër, të subjektit “ERIM” sh.p.k:

2. Vendndodhja e veprës së marrjes nr.4 (KRGJSH)

Nga: X: 523125 Y: 4602778 Z: +1220 m.m.n.d

Në: X: 522294 Y: 4602339 Z: +1220 m.m.n.d

3. Asnjë tregues tjetër nuk ndryshon përveç gabimit material.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

